



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 5 DHJETOR 2024**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 5. DECEMBRA 2024. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative

Dnevni red

1. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 08/L-291 o Upravnom sudu

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Nuk e di sa kohë i nevojitet sistemit tonë për ta hapur në seancë krejt të re, të shohim ndoshta na lajmërojnë me kohë se si të procedojmë, sa duhet të presim faktikisht.

Por, meqenëse është vetëm një pikë, atëherë vazhdojmë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative

Të nderuar deputetë,

Për ta shqyrtuar këtë projektligj duhet të bëhet shmangia nga afati i paraparë me nenin 52, sepse aty përcaktohet që deputetëve u shpërndahen materialet së paku dy ditë përpara mbajtjes së seancës. Kurse, raporti u është shpërndarë deputetëve sot. Kush e bën këtë propozim për shmangie?

Deputeti Rrustemi, urdhëroni, në emër të deputetëve, a po?

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Në emër të 40 deputetëve nënshkrues dhe të kërkesës për seancë të jashtëzakonshme me vetëm një pikë të rendit të ditës, që është Shqyrtimi në lexim të dytë të Projektligjit nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, propozojmë shmangie nga Rregullorja në kuptimin e afateve për shpërndarjen e materialeve të deputetëve.

KRYETARI: Mirë, e keni dëgjuar këtë kërkesë, e formuloi zoti Rrustemi, ne vetëm e hedhim në votim. Përgatituni për votim, votojmë tash!

62 vota për, zero kundër, zero abstenime. Miratohet shmangia, kështu që kjo na hap rrugë për trajtimin e projektligjit në shqyrtim të dytë. Prandaj, mund të procedojmë.

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin, na rekomandon ta aprovojmë.

Komisioni për Buxhet thotë se ky projektligj përmban kosto buxhetore shtesë, por është e përballueshme për buxhetin e Republikës së Kosovës, kurse amendamentet nuk përmbajnë të tilla.

Komisioni për Integrim Evropian ka vlerësuar se projektligji dhe amendamentet nuk rregullohen në mënyrë të veçantë nga Legjislacioni i BE-së, kurse Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e

Komuniteteve të Kthimit ka vlerësuar se projektligji nuk i cenon dhe nuk i prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Zoti Rrustemi, në emër të komisionit!

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar natyrisht në procedurë të rregullt Projektligjin nr. 08/L-291 për Gjykatën Administrative. Natyrisht grupi punues ka organizuar diskutime të gjera me aktorë institucionalë e organizata të ndryshme dhe e ka paraqitur raportin me amendamente.

Ky është një projektligj i rëndësishëm, sepse e themelon një gjykatë speciale administrative që do t'u ndihmojë qytetarëve në realizimin e të drejtave të tyre, por edhe do t'i shkarkojë gjykatat nga rastet administrative me gjyqtarë profesionalë e të specializuar në çështjet administrative, dhe do të rrisë efikasitetin e realizimit të të drejtave të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës në raport me organet publike.

Prandaj, i ftoj deputetët që ta miratojnë. Dua të them që ka qenë një nga zotimet tona politike të rëndësishme në funksion të avancimit të drejtësisë administrative në rastin konkret.

KRYETARI: Mirë, ky ishte pak raporti i komisionit, pak fjalim i Vetëvendosjes, sidomos ai kur the është premtim... Mirë, 17 amendamente i kemi. I hedhim në votim amendamentet. Përgatituni për votim, votojmë tash!

63 vota për, zero kundër, zero abstenime. Kuvendi i miraton 17 amendamentet për Gjykatën Administrative.

Tash po e hedhim projektligjin së bashku me këto që i miratuam. E votojmë projektligjin, votojmë tash!

62 vota për, zero kundër, zero abstenime. Konstatohet që Kuvendi e miratoi Projektligjin e Gjykatës Administrative.

Me këtë rast i mbylli punimet e kësaj seance. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*